



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

**V E N D I M**

**I.**

MIRATOHET raporti, nr. prot. 14-050/01-85379/23, i datës 28.4.2023, i Komisionit Profesional për Verifikimin dhe Vlerësimin e Kontratave për Dhënien në Shfrytëzim të Pronave Komunale.

**II.**

Duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në Raport, sipas pikës 1. të këtij vendimi, obligohe Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë tjera përkatëse të përcaktuara me këtë vendim, që t’i ndërmarrin veprimet si në vijim:

1. **Kontrata me Qendrën Kardiale të Kosovës, e cila është valide deri më 3.9.2027, duhet të plotësohet me aneks kontratë nga Kryetari i Kryeqytetit për ta legjitimuar mënyrën e re të zbatimit të kontratës, duke përfshirë pikat si në vijim:**
  - 1.1. Shuma e trajtimit në bazë të nenit 3 të kontratës bazë me Qendrën Kardiale të Kosovës, të kthehet në pagesë qiraje mujore, e cila do të ketë destinim shëndetësinë, respektivisht do të shpërndahen për trajtimin e pacientëve të kryeqytetit.
  - 1.2. Në aneks-kontratën e re me Qendrën Kardiale, duhet të parashihet mbikëqyrja e zbatimit të kontratës deri më 3.9.2027, dhe menjëherë të bëhet caktimi i menaxherit të kontratës me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.
2. **Kontrata “Ndërtimi me koncesion i garazheve publike pranë QKUK-së, sipas projektit të Komunës së Prishtinës, nr. 40-6/05”, duhet të plotësohet me aneks-kontratë nga Kryetari i Kryeqytetit, duke përfshirë pikat si në vijim:**
  - 2.1. Koncesionari obligohet që brenda afatit prej 18 muajsh nga dita e nënshkrimit të aneks-kontratës, të përfundojë të gjitha obligimet që rrjedhin nga kontrata bazë dhe aneks-kontrata, duke përfshirë përfundimin e punimeve ndërtimore dhe aplikimin për pranim teknik.
  - 2.2. Komuna e Prishtinës obligohet që procesin e pranimit teknik të objektit ta përfundojë brenda afatit ligjor, pas aplikimit për pranim teknik nga koncesionari.

- 2.3. Koncesionari obligohet që t'ia paguajë Komunës së Prishtinës vlerën prej 86,215.54 euro, si vlerë e qirasë për pjesën e shfrytëzuar të objektit, nga muaji prill 2015 e deri në muajin maj 2023.
- 2.4. Po ashtu, gjatë periudhës derisa koncesionari të përfundojë punimet ndërtimore dhe të marrë certifikatën e përdorimit, obligohet që shumën prej 888.82 euro t'ia paguajë Komunës së Prishtinës, në baza mujore, si pagesë për pjesën e objektit që e ka dhënë me nënqira.
- 2.5. Të përcaktohet një pikë tjetër në aneks-kontratë, që në rast të moszbatimit të pikave të mësipërme brenda afateve të përcaktuara, Komuna e Prishtinës merr të drejtën e shkëputjes së kontratës dhe të marrë në pronësi objektin e ndërtuar sipas kontratës së koncesionit dhe aneksit të saj.

### III.

Ky vendim duhet të zbatohet brenda afatit prej, më së largu 30 ditësh nga dita e publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

### IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Pronës, Zyra Ligjore dhe Drejtorja e Financave.

### V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-035/01-183654/23, më 05.09.2023

